



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. *43/155-15* Prot.
Nr. Dok. 202100397/15

Tiranë 26/12 2024

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme lidhur me monitorimin e sjelljes së kafshëve shtëpiake, vendosjen e sinjalistikës së nevojshme në ambiente publike, si dhe kontrollin dhe higjenizimin e ambienteve publike nga ndotja e kafshëve të shoqërimin.*

Drejtuar: **Bashkisë**

TIRANË

Agjencisë së Mbrojtjes të Konsumatorit

Adresa: Pranë Bashkisë

TIRANË

Të nderuar!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike, duke marrë shkas nga shqetësimet e ngritura në median e shkruar dhe vizive, më konkretisht të një kronike me titull, "Pamje të rënda/Ishte duke luajtur me shokët, fëmija 10-vjeçar kafshohet nga pitbulli endacak në Tiranë".¹ në përputhje me nenin 13, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, ka ndërmarrë me iniciativë shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Sikundër thuhet shprehimisht në këtë kronikë, fëmija 10 vjeçar është kafshuar nga një qen i racës pitbull, teksa luante me moshatarët e tjerë pranë shtëpisë së tij. Shqetësimin

¹ <https://www.faxweb.al/pamje-te-renda-ishte-duke-luajtur-me-shoket-femija-10-vjec-kafshohet-nga-pitbulli-ne-tirane/>

për këtë ngjarje, babai i fëmijës, O.K., e ka denoncuar në institucionet vendore, dhe se, punonjësit e Bashkisë Tiranë, kanë reaguar duke kapur qenin dhe sterilizuar atë, veprim i cili ka shkaktuar reagimin e aktivistëve për mbrojtjen e kafshëve, të cilët kanë bërë thirrje për mosrëmbimin e kafshëve dhe sterilizimin e tyre.

Në funksion të një hetimi të plotë e të gjithanshëm administrativ të çështjes, bazuar në nenin 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet, se: *"Organet dhe funksionarët publik janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij"*, si dhe nenin 19, pika "b", të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *"Për Avokatin e Popullit"*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin"*, Avokati i Popullit ka kërkuar sipas kompetencave respektive ligjore për këtë problematikë:

1. Me shkresat nr. K3/I56-2 prot, datë 04.05.2021 dhe nr. K3/I56-8 prot, datë 20.02.2024, informacion dhe shpjegime Bashkisë Tiranë, Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit (AMK) dhe Policisë Bashkiake, pranë kësaj Bashkie, si dhe Drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit Tiranë, lidhur me:

- masat e marra prej strukturave përkatëse pranë Bashkisë Tiranë, apo Policisë së Shtetit për sigurimin e shëndetit dhe jetës së individëve nga sulmet e mundshme prej qenve shtëpiakë, pronarët e të cilëve në më të shumtën e rasteve i lenë pa maskë mbrojtëse;
- shpjegime për mospenalizimin e pronarëve të qenve shtëpiakë, të cilët në ambiente publike i lenë pa maskë mbrojtëse këto kafshë;
- identifikimin e pronarëve të çdo qeni shtëpiak, regjistrimin e çdo qeni në regjistrin e autoritetit kompetent në përputhje me rregulloren e nxjerrë prej Ministrit kompetent, si dhe, numrin e përgjithshëm të tyre;
- numrin e masave administrative të vendosura ndaj pronarëve të kafshëve (qenve) në kuptim dhe zbatim të nenit 14, 15, 16, pika 6, gërma "e" të vendimit nr. 156, datë 21.12.2018 *"Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Tiranë"*, të Këshillit Bashkiak Tiranë (VKB nr. 156/2018), për vitet 2021, 2022 dhe 2023;
- vlerësimin e legjislacionit për çështjen në fjalë;
- gjendjen e vendosjes së sinjalistikës në ambientet publike në të cilat lejohet apo nuk lejohet qarkullimi i kafshëve (qenve) dhe a konsideroni të plotë dhe të përfunduar vendosjen e kësaj sinjalistike, si dhe mundësive për vendosjen e saj sa më parë e mundur;

2. Me shkresën nr. K3/I56-13 prot, datë 23.08.2024, informacion dhe shpjegime Agjencisë Kombëtare të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), si dhe Agjencisë Rajonale të Shërbimit Veterinar (ARSHV), lidhur me:

- Informacion rreth veprimtarisë që kryhet prej organeve AKVMB dhe ARSHV, në zbatim të ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011, *"Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë"*, lidhur me kafshët e shoqërimit (qenve të luksit/shtëpiak) si dhe qenve të rrugës;

- Prezantimin e problemeve të mundshme në veprimtarinë tuaj lidhur me kafshët e shoqërimit (qenve shtëpiak, të luksit) si dhe qenve të rrugës;
- Nëse njësi të vetëqeverisjes vendore kanë kërkuar përcaktimin e formatit të sinjalistikës lidhur me përmasat, ngjyrat simbolet, sikurse përcaktuar në Kreun III, pika 7, të VKM-së nr. 475, datë 30.07.2021. "Për bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes vendore me Shërbimin Veterinar"? Nëse po, në sa raste është bërë një kërkesë e tillë, dhe cilat janë njësitë vendore që kanë kryer kërkesë me këtë objekt kërkimi?
- A kryhet rregullisht identifikimi dhe regjistrimi i qenve të shoqërimit në regjistrë? Sa është numri i përgjithshëm i tyre? Sa është numri i përgjithshëm i qenve të racave të rrezikshme: spic, hasky, rotvailer, pitbull, doberman, qeni i sharrit, pastor, kangalli turk, bokser;
- Nëse ministri ka miratuar rregulloren përkatëse ku përcaktohet forma e identifikimit të detyrueshëm të qenve;
- Cila është veprimtaria e ndjekur prej organeve tuaja nëse pronari i kafshës së shoqërimit nuk ka përmbushur detyrimin për njoftimin e shërbimit veterinar për blerjen e tij/saj?
- Çdo informacion tjetër lidhur me këtë çështje.

Bashkia Tiranë, struktura e saj, referuar përcaktimeve të VKB-së nr. 156/2018, ka për detyrë funksionale konstatimin dhe dënimin e kundërvajtjeve administrative, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulojnë. Në nenin 13 të këtij vendimi, përcaktohet se:

"1. Për atë që nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative nga pronarët/kujdestarët në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, këto veprime:

a. Të sigurojnë, që në ambientet e përbashkëta, në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, kafshët/shpendët e tyre të mos paraqesin rrezik për njerëzit ose kafshët/shpendët e tjera, duke zbatuar detyrimin, që:

- Qeni duhet të mbahet nga pronari/kujdestari, me rrip jo më të gjatë se 1.5 (një pikë pesë) metra.

- Të vendosin maskat mbrojtëse për qentë e racave të rrezikshme: spic, hasky, rotvailer, pitbull, doberman, qeni i sharrit, pastor, kangalli turk, bokser.

- Të shmangin ndotjen e ambienteve të përbashkëta, në bashkëpronësi dhe hapësirave publike nga kafshët/shpendët e tyre, dhe në rast ndotje, të pastrojnë ambientin pas defektimit.

- Të kryejnë vaksinimin e detyrueshëm vjetor kundër tërbimit.

- Të vaksinojnë dhe kontrollojnë pranë mjekut të klinikës veterinare, kafshët/shpendët e shoqërimit dhe ato të luksit.

- Të respektojnë mirëqenien e kafshëve/shpendëve të tyre.

- Ndalohet kategorikisht, mbajtja në errësirë të plotë, të përhershme dhe/ose të lidhur gjatë gjithë kohës i kafshëve/shpendëve shtëpiake, të shoqërimit dhe të luksit.

- Personat, të cilët mbajnë kafshë/shpendë shtëpiake, të shoqërimit apo të luksit, në banesa individuale apo në bashkëpronësi në zona të urbanizuara, janë të detyruar të mos lejojnë që ato të kryejnë ndotje dhe të shkaktojnë zhurma, duke u bërë shqetësim për pjesëtarët e tjerë të komunitetit, duke cenuar gëzimin e qetë të pronës së tyre.

- Mbajtja dhe/ose rritja e kafshëve, bagëtisë ose shpendëve të çdo lloji, pavarësisht numrit është e ndaluar brenda të gjitha njësive të banimit ose pronës së përbashkët.

- *Mbajtja apo qarkullimi i kafshëve blegtoralë jo shtëpiake, në mjedise publike të qendrave urbane si: kuaj, lopë, dhen, dhi, derra, shpendë (pula) etj;*
- b. *Ndërsen kafshët kundër njëra – tjetrës ose përdor kafshën për luftime a shfaqje, që shkaktajnë dhimbje, dëmtime, plagosje ose ngordhjen e tyre.*
- 2. *Si edhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje administrative, parashikuar në aktet nënligjore/normative të miratuar nga këshillit bashkiak ose kryetari i Bashkisë së Tiranës”.*

Gjithashtu, njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas aktit nënligjor, VKM-së nr. 475/2021, Kreu III, pika 7, kanë si objekt veprimtarie dhe sigurimin e masave lidhur me vendosjen e sinjalistikës së nevojshme në ambientet publike, si: rrugë, parqe, kënde lojrash, etj, me qëllim që, kafshët e shoqërimit (Kafshë shoqërimi janë kafshët që mbahen dhe rriten nga njeriu, në shtëpi, jo për qëllime përfitimi²) të mos paraqesin rrezik për njerëzit ose kafshët e tjera.

Ndër detyrat funksionale të përcaktuara në kuadrin rregullator të lartpërmendur për njësinë e vetëqeverisjes vendore, është dhe:

- Bashkëpunimi me drejtoritë rajonale të AKVMB, me drejtoritë rajonale të Shërbimit Veterinar, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU), si dhe me strukturën përgjegjëse për veterinarinë (SPV) në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR).

Institucioni i Avokatit të Popullit, ngjarjen e bërë publike nga ana e medias, e vlerëson shqetësuese dhe në cenim të së drejtës vetjake të jetës dhe shëndetit të personit, për këtë arsye, kërkon vëmëndjen tuaj në trajtimin e kësaj problematike tepër shqetësuese e cila dëmton shëndetin dhe vë në rrezik jetën e personit.

AMK, pranë Bashkisë Tiranë, në përgjigjen e dhënë, fillimisht me shkresën nr. 213/1 prot., datë 24.05.2021, bën me dije, ndër të tjera, se:

“Referuar ankesave të qytetarëve, si dhe bazuar në ligjin nr. 10465, datë 29.09.20211, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, VKM-në nr. 230, datë 20.03.2013, “Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standardeve të Shërbimit Veterinar të qeverisjes vendore”³, Bashkia Tiranë, ka miratuar vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 156, datë 21.12.2018, i cili përcakton vendosjen e masave administrative për pronarët e kafshëve të shoqërimit gjatë qëndrimit të tyre në ambiente dhe parqe publike. Përsa i përket identifikimit dhe regjistrimit të qenve me pronar, ju bëjmë me dije se, ky është një funksion ligjor i strukturave veterinarë vendore. Ligji nr. 10465, datë 29.09.20211 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” përcakton funksionet e strukturave të Shërbimit Veterinar për kafshët e shoqërimit (qentë dhe macet me pronar), funksion ky, i cili bazuar në ligjin sa më sipër i takon Agjencisë Rajonale të Shërbimit Veterinar, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të cilat duhet të kontrollojnë shëndetin e këtyre kafshëve dhe të

² Neni 4, pika 33, e ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”

³ Shfuqizuar me VKM-në nr. 475, datë 30.07.2021 “Për bashkëpunimin e njesive të vetëqeverisjes vendore me Shërbimin Veterinar

ndërtojnë databazën e qenve me pronar. Me hyrjen në fuqi të VKB-së nr. 156, datë 21.12.2018, neni 13, pika 1, nga ana e strukturave tona janë kryer fushata sensibilizuese për pronarët e kafshëve të shoqërimit, të cilët shëtisin kafshët në parqe dhe ambiente publike. Sa më sipër, në vazhdimësi jemi duke marrë masa administrative për pronarët të cilët nuk i zbatojnë këto rregulla”.

Më tej, në përgjigje të informacionit dhe shpjegimeve të kërkuara, AMK, pranë Bashkisë Tiranë, me shkresën nr. 1713/1 prot. datë 28.02.2024, drejtuar Avokatit të Popullit, parashtron, se:

“... Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit (AMK), bazuar në ligjin nr. 10465, datë 29.09.2021, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 475, datë 30.07.2021, “Për bashkëpunimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore me Shërbimin Veterinar”, nuk ka si objekt kontrolli qentë me pronar. Kafshët e shoqërimit janë objekt i kontrollit të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, strukturë në Varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Është detyrim ligjor i Shërbimit Veterinar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që të zbatojnë ligjin veterinar dhe konkretisht nenin 12, të këtij ligji, i cili përcakton që të gjithë qentë me pronar duhet të identifikohen dhe të rregjistrohen në regjistrin që administrohet nga Autoriteti Kompetent, si dhe neni 73, i cili përcakton detyrimet e pronarëve të kafshëve të shoqërimit. Aktualisht AMK po përmbush misionin e saj sipas objektivave dhe njëkohësisht prej disa vitesh po zhvillon edhe fushata ndërgjegjësuese në zbatim të vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë, me nr. 156, datë 21.12.2019, i cili vendos rregullat për pronarët e kafshëve të shoqërimit në ambientet publike, si rrugë, parqe, kënde lojrash, etj. më qëllim që kafshët e shoqërimit të mos paraqesin rrezik për njerëzit ose kafshët e tjera me qëllim edukimin e qytetarëve për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve. Mbetet detyrë e strukturave të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të zbatojë legjislacionin veterinar në fuqi për kafshët e shoqërimit dhe njëkohësisht të plotësojë këtë legjislacion me rregulloret dhe udhëzimet përkatëse”.

Në përgjigjet e dhëna prej Bashkisë Tiranë, strukturës në varësi të saj, konstatohet se:

- Nuk është dhënë informacioni i kërkuar;
- Mosnjohje dhe mosushtrim i detyrimeve ligjore të parashikuara në VKB-në nr. 156/2018, prej AMK-së pranë Bashkisë Tiranë;
- Reduktimi i detyrimit në kryerjen e fushatave ndërgjegjësuese në zbatim të VKB-së nr. 156/2018.

Gjithashtu, AMK nuk informon rreth masave administrative të mundshme (gjobë) të vendosura prej saj gjatë viteve 2021, 2022 dhe 2023, ndaj pronarëve/kujdestarëve, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, për shkak të mosushtrimit të kontrollit/detyrimit të përcaktuar në nenin 16, pika 6, gërma “d”, të VKB-së nr. 156/2018, se:

Neni 16
“Masa e gjobës për kundërvajtjet administrative kundër rregullave të bashkëjetesës shoqërore

Masat e sanksionimit me gjobë për kundërvajtjet administrative të parashikuara në këtë vendim:

...

6. Për kundërvajtje administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë së Tiranës, do të vendosë gjobë:

- d. Në masën 1 000 (njëmijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 13, masë e cila dyfishohet në rast të përsëritjes së shkeljes brenda një periudhe 3 (tre) mujore nga pronari/kujdestari i kafshëve/shpendëve”;*
- e. Në masën 1 000 (njëmijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 13, masë e cila dyfishohet në rast të përsëritjes së shkeljes brenda një periudhe 3 (tre) mujore nga pronari/kujdestari i kafshëve/shpendëve”.*

Kjo çështje adresohet prej AMK-së, në kundërshtim me përcaktimin e nenit të sipërcituar, tek AKVMB, strukturë në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Mosnjohja dhe mosushtrimi i detyrimit prej AMK-së, sikurse përcaktuar në nenin 16, pika 6, gërma “d”, të VKB-së nr. 156/2018, është tregues se kontrolli ndaj pronarëve/kujdestarëve, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, nuk është kryer asnjëherë, së paku prej daljes së VKB-së nr. 156/2018. Fakti që dhe pas 6 vitesh nga nxjerrja e kësaj VKB-je, AKM-ja nuk njeh dhe ushtron detyrimin ligjor, është tregues i mungesës së kontrollit ndaj veprimtarisë administrative të saj nga ana e organit epror.

Mosnjohja dhe mosushtrimi prej AKM-së i detyrimit për kontrollin e pronarëve/kujdestarëve, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, ka bërë dhe bën që kundërvajtjet administrative në këtë fushë të jenë jashtë kontrollit. Kjo situatë ka ndikuar dhe ndikon në rritjen e rrezikut të dëmtimit të shëndetit si dhe jetës së njerëzve, ndotjes në vijimësi prej kafshëve/qenve të shoqërimin, të ambienteve në bashkëpronësi, hapësirave publike, me mundësi përhapje të sëmundjeve. Në realitetin e sotëm, veçanërisht në zona të gjelbra, trotuare rrugësh, ambiente në bashkëpronësi, lehtësisht mund të konstatohet, ndotjet që shkaktojnë qentë e shoqërimin, si dhe, mosreagimin e pronarit/kujdestarit për respektimin e detyrimit ligjor për pastrimin e ndotjes së shkaktuar, sikurse parashikuar në nenin 73, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, se:

Neni 73

Detyrimet e pronarëve të kafshëve të shoqërimit

...

3. Pronarët e kafshëve të shoqërimit detyrohen:

...

e) të shmangin ndotjen e vendeve publike nga kafshët, si dhe të pastrojnë vendin pas defekimit, në rast ndotjeje”,

VKM-së nr. 447, datë 16.06.2010 “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, pika 5, gërma “c” dhe “d”, se:

“c. Qentë nuk do të shëtiten në zonat me bar pranë njësive të banimit dhe nëse gjatë kalimit mund të ndodhë të shkaktohet papastërti, zona duhet të pastrohet nga pronari. d. Pronarët janë përgjegjës për të gjitha dëmet e shkaktuara nga kafshët e tyre në zonat e përbashkëta dhe në pronat e të tjerëve”.

si dhe VKB-së nr. 156/2018, neni 13, pika 1, gërma “a”, se:

“Personat , të cilët mbajnë kafshë/shpend shtëpiake, të shoqërimit apo të luksit, në banesa individuale apo në bashkëpronësi në zona të urbanizuara, janë të detyruar të mos lejojnë që ato të kryejnë ndotje dhe të shkaktojnë zhurma, duke u bërë shqetësim për pjestarët e tjerë të komunitetit, duke cenuar gëzimin e qetë të pronës së tyre”.

Më tej, VKB-ja nr. 156/2018, në nenin 14, lidhur me masat parandaluese për kundërvajtjet administrative, parashikon se:

“Përveç sanksionit administrativ të vendosur nga strukturat konstatuese për secilën nga kundërvajtjet e parashikuara në këtë vendim, kundërvajtësit i nënshtrohen edhe konfiskimit të sendeve/mallrave që kanë shërbyer apo që ishte caktuar për të shërbyer si mjete për kryerjen e kundërvajtjes administrative të parashikuara në këtë vendim”.

Në përgjigjen e dhënë prej AKM-së me shkresën nr. 1713/1 prot, datë 28.02.2024, drejtuar Avokatit të Popullit, deklarohet se po përmbushet misioni sipas objektivave, ndërkohë që nuk njihet dhe ushtrohet detyrimi/kompetenca sikurse bërë e ditur sa sipër.

Mungesa e kontrollit në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, ka krijuar dhe krijon premisa që ngjarjet e sulmimit dhe rrezikimit të shëndetit dhe jetës së njerëzve të përsëriten, për shkak të mosrespektimit të detyrimeve nga ana e pronarëve/kujdestarëve në mbajtjen e kafshëve të shoqërimit sipas kushteve të përcaktuara në nenin 73 të ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011. “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 10465/2011), se:

“Neni 73

Detyrimet e pronarëve të kafshëve të shoqërimit

...

3. Pronarët e kafshëve të shoqërimit detyrohen:

...

d) të sigurojnë që kafshët të mos paraqesin rrezik për njerëzit ose kafshët e tjera, duke zbatuar detyrimin e vendosjes së maskës mbrojtëse në gojë, kur i nxjerrin shëtitje qentë agresivë”,

VKM-në nr. 447, datë 16.06.2010 “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, pika 5, gërma “b”, se:

“Qentë të mbikqyren me kujdesin maksimal, të mbahen me zinxhirë dhe të jenë nën kontrollin e pronarëve të tyre sa herë që janë jashtë njësisë individuale dhe nuk lejohet që të vrapojnë të zgjidhur në çdo kohë ose të ndërhyjnë në të drejtat, rehatinë e banorëve të tjerë”,

apo në nenin 13, pika 1, gërma “a”, të VKB nr. 156/2018, se:

“Kundërvajtje administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambiente në bashkëpronësi dhe hapsirat publike.

- **Qeni duhet të mbahet nga pronari/kujdestari, me rrip jo më të gjatë se 1.5 (një pikë pesë) metra.**
- **Të vendosin maskat mbrojtëse për qentë e racave të rrezikshme: spic, hasky, rotvailer, pitbull, doberman, qeni i sharrit, pastor, kangalli turk, bokser”.**

Përmbushja e këtij detyrimi prej Bashkisë Tiranë, referuar përgjigjes së dhënë prej AKM-së, nuk rezulton të jetë kryer ndonjëherë.

Detyrimi për ushtrimin e kompetencës lëndore dhe tokësore prej AMK-së, nuk ka ndodhur për shkak se kjo e drejtë i është deleguar si kompetencë një organi tjetër publik, pra AKVMB-së siç pretendohet.

AKVMB, Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Tiranë, në përgjigje të kërkesës së Avokatit të Popullit, për informacion dhe shpjegime, me shkresën nr. 469/1 prot, datë 03.09.2024, shprehet midis të tjerave, se:

“Të gjitha kafshët e shoqërimit të llojit qen duhet t’i nështrohen procesit të identifikimit sipas legjislacionit në fuqi por duke qenë se është në proces krijimi i sistemit për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve të shoqërimit, kjo procedurë ligjore aktualisht kryhet nga klinikat dhe spitalet veterinarë.

Klinikat dhe spitalet veterinarë ofrojnë këtë shërbim dhe për çdo rast duhet që kafshët t’i pajisin me sistemin e identifikimit ISO (mikroçip) dhe kryejnë regjistrimin në një format të dërguar nga Autoriteti Kompetent dhe në database.

Ministri ka miratuar me urdhër nr. 118, datë 02.03.2023, rregulloren përkatëse "Për funksionimin e klinikave dhe spitaleve veterinare".

...
Në punën e përditshme kemi plot ankesa ku kafshët e shoqërimit bëhen shkak për prishjen e qetësisë publike. Shpesh herë kemi bashkëpunuar me njësitë e qeverisjes vendore për dërgimin e kafshëve tek strehëza e qenve, e cila është nën juridiksionin e Bashkisë Tiranë, në rastet e kafshëve pa pronar.

Janë marrë edhe masa administrative sipas legjislacionit ku kemi vënë edhe gjoba kur kafshët kanë qenë të paidentifikuara (me mikroçip), apo nëse nuk kanë qenë të pajisura me dokumentacionin veterinar (pasaporta veterinare) në të cilën shënohen vaksinimet dhe trajtimet e kryera".

Konstatohet nga informacioni dhe shpjegimet si më sipërcituar, se AKVMB-ja në përputhje me parashikimin e nenit 134, pika 1, gërma "a", paragrafi "ii" të ligjit nr. 10465/2011, ushtron kompetencën e vendosjes së gjobës, ndaj pronarit/kujdestarit të kafshës së shoqërimit, në rastet kur ai vepron në kundërshtim me parashikimin e nenit 12 të këtij ligji, se:

"Identifikimi i qenve

- 1. Të gjithë qentë duhet t'i nënshtrohen procesit të identifikimit.*
- 2. Të gjithë qentë e identifikuar duhet të regjistrohen në regjistrin që administrohet nga autoriteti kompetent.*
- 3. Pronarët e qenve mbulojnë koston e pasaportës mjekësore veterinare dhe identifikimin e detyrueshëm të qenve (rripit identifikues ose mikroçipit).*
- 4. Ministri miraton rregulloren përkatëse, ku përcaktohet forma e identifikimit të detyrueshëm, sipas pikës 1 të këtij neni.*
- 5. Pronari i qenit është i detyruar që, brenda 14 ditëve, të njoftojë shërbimin veterinar për blerjen e një qeni ose të kërkojë çregjistrimin e qenit, në rastet e zhdukjes, shitjes, dhurimit ose ngordhjes së kafshës".*

Kompetenca e dhënë AKVMB për vendosjen e gjobës ndaj pronarit/kujdestarit të kafshës së shoqërimit, në kushtet e parashikuara në nenin 12 të ligjit nr. 10465/2011, nuk është e njëjtë me kompetencën e dhënë AMK-së pranë Bashkisë Tiranë, me VKB-në nr. 156, datë 21.12.2018, 16, pika 6, gërma "d", për vendosjen e gjobës ndaj pronarit/kujdestarit të kafshës së shoqërimit.

Tjetër çështje e pa trajtuar prej Bashkisë Tiranë, është mosmarrja e masave për vendosjen e sinjalistikës së nevojshme në ambientet publike, si rrugë, parqe, kënde lojtash, etj, me qëllim që kafshët e shoqërimit të mos paraqesin rrezik për njerëzit dhe kafshët e tjera.

Ky detyrim i njësisë së vetëqeverisjes vendore është i përcaktuar në Kreun III, pika 7. të VKM-së nr. 475, datë 30.07.2021. *“Për bashkëpunimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore me Shërbimin Veterinar”*. se:

“Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë masat lidhur me vendosjen e sinjalistikës së nevojshme në ambientet publike, si rrugë, parqe, kënde lojrash, etj. me qëllim që kafshët e shoqërimit të mos paraqesin rrezik për njerëzit ose kafshët e tjera. Format i sinjalistikës lidhur me përmasat, ngjyrat, simbolet përcaktohen nga AKVMB-ja”.

Nga përgjigjet e dhëna Avokatit të Popullit, prej AMK-së, vlerësojmë se kjo çështje nuk ka marrë vëmendjen e duhur prej saj apo Bashkisë Tiranë.

Ne procesin e hetimit administrativ të çështjes/ve, Policia Bashkiake, pranë Bashkisë Tiranë, në përgjigje të kërkesës për informacion dhe shpjegime, me shkresën nr. 8590/1 prot, datë 01.03.2024, drejtuar Avokatit të Popullit, bën me dije, se:

*“Bazuar në ligjin nr. 89, datë 22.12.2022, neni 9, pika 3, gërma “a” dhe “b”, si dhe VKB-në nr. 156, datë 21.12.2018, neni 13 dhe pikës 6 të nenit 16, Policia Bashkiake në çdo adresim problematike apo konstatim të punonjësve të saj, **njofton punonjësit e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, pranë Bashkisë Tiranë, si organ kompetent për ndjekjen e problematikave të parashtruara në shkresë, si dhe i mbështet ato në zbatimin e masave që vendosen të merren sa herë na kërkohen.** Kërkesa dhe informacionet e tjera të cilat janë parashtruar në shkresë, nuk janë objekt i punës së Policisë Bashkiake dhe nuk kemi kompetencë veprimi”*.

Nga informacioni i dhënë, kuptohet se kjo strukturë e Bashkisë Tiranë, ka adresuar rast pas rasti çështje që lidhen me pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapsirat publike, pranë AMK-së, dhe se, ky organ publik, nuk ka reaguar në përmbushjen e detyrimeve të vendosura.

Për çështjen në fjalë, Drejtoria Vendore e Policisë së Shtetit me shkresën nr. 4431/4 prot, datë 25.05.2021, drejtuar Avokatit të Popullit, informon ndër të tjera, se:

“Shërbimet e kontrollit të territorit në rastet e konstatimit të pronarëve të kafshëve shtëpiake (qentë) i kanë këshilluar dhe bërë me dije për detyrimet ligjore që ata kanë në lidhje me mbajtjen e maskës mbrojtëse në ambientet publike, për sigurinë e shëndetit dhe jetës së individëve.

Për personat që nuk kanë zbatuar detyrimet ligjore në lidhje me kafshët shtëpiake (qentë) ka filluar procedimi penal si më poshtë:

- Më datë 08.03.2021, janë referuar materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për shtetasin N.B.P. banues në Tiranë, sepse në orën

11.40 në rrugën "Ramazan Bogdani", ka lëshuar qenin e tij me dashje, duke kanosur shtetasin G.L.J., bazuar në nenin 84 të Kodit Penal.

- Ka filluar procedimi penal, pasi fëmija e shtetasit O.K. është dëmtuar nga një kafshë (qen) në situatë rruge, në adresën Priskë e Madhe, Dajt, Tiranë.

Në disa zona të qytetit të Tiranës, dhe sidomos në ato periferike, ka qenë rrugësh të cilët janë të pavaksinuar dhe janë burim i sëmundjeve të ndryshme dhe rrezik për kalimtarët.

Regjistri për identifikimin e pronarëve të çdo qeni nuk administrohet nga Policia e Shtetit, por detyrimin ligjor e kanë institucione të tjera".

ndërsa Komisariati nr. 2, i kësaj Drejtorie, me shkresën nr. 2860/1 prot. datë 18.05.2021, drejtuar Avokatit të Popullit, bën me dije, ndër të tjera, se:

"Nuk është kompetencë e punonjësve të Policisë për të marrë masa për sigurinë dhe jetën e individëve nga sulmet e mundshme prej qenve shtëpiakë, të cilët janë lenë pa maska mbrojtëse nga pronarët. Në rast konstatimi nga ana jonë këshillohen. Ne nuk mbajmë asnjë evidencë apo informacion në lidhje me pronarët e kafshëve shtëpiake. Gjithashtu, nuk kemi asnjë të dhënë në lidhje me rastet e penalizimit për pronarët të cilët mbajnë këto kafshë shtëpiake pa maskë".

Në përgjigjet e dhëna prej strukturave të Policisë së Shtetit, konfirmohet:

- Ekzistenca e problemit të mbajtjes pa maskë mbrojtëse të qenve të shoqërimit në ambientet publike;
- Ekzistenca në disa zona të qytetit të Tiranës, dhe sidomos në ato periferike, të qenve të rrugës, të pavaksinuar.

Kjo situatë problematike gjen pasqyrim dhe në artikujt mediatik⁴.

Mosushtrimi prej AKM-së, pranë Bashkisë Tiranë, si i vetmi organ i ngarkuar me detyrimin e kontrollit të pronarëve/kujdestarëve, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, është shqetësues, pasi ka krijuar dhe krijon premisë që ngjarjet për sulmimin e njerëzve nga kafshët e shoqërimit të përsëriten. Mosvendosja e maskës mbrojtëse kafshës së shoqërimit, në ambientet publike ose në mjedise të hapura për publikun, kur kanë ardhur pasoja në dëm të shëndetit, të një personi, plagosjes së rëndë apo vdekjes së tij, parashikohen të dënueshme me gjobë ose burgim, sipas nenit 207/a të ligjit nr. 44/2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë".

Legjislacioni në fuqi, për qentë dhe macet e rrugës (endacake), parashikon në nenin 54 të ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011, midis të tjerave, se:

⁴ Linku: joq-albania.com. "Banorët e Tiranës në hall me qentë e rrugës: Kemi frikë të dalim jashtë"

"Funksionet e njësive të qeverisjes vendore

1. Strukturat veterinare në njësitë e qeverisjes vendore duhet:

...

ç) të mbajnë nën kontroll dhe të zbatojnë legjislacionin në fuqi për eliminimin e qenve dhe maceve të rrugës;

...

2. Standardet e shërbimit veterinar të qeverisjes vendore dhe detyrat specifike për arritjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave".

Në funksion të parashikimit të dispozitës ligjore të sipërcituar, neni 54, pika 2. e ligjit nr. 1065/2011, është mundësuar nxjerrja e VKM-së nr. 230, datë 20.3.2013 "Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standardeve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore", shfuqizuar me VKM-në nr. 475, datë 30.07.2021, "Për bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar". Në Kreun III, "Mbikqyrja dhe mbajtja në kontroll e qenve dhe maceve endacake pa pronarë", të VKM-së nr. 475, datë 30.07.2021, përcaktohet, se:

"III. Mbikqyrja dhe mbajtja nën kontroll e qenve dhe maceve endacake pa pronarë

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mbajnë nën kontroll lëvizjen e qenve dhe maceve të rrugës. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në lidhje me situatën epizotike të qenve dhe maceve të rrugës, në rast dyshimi, njoftojnë menjëherë drejtoritë rajonale të AKVMB-së. AKVMB-ja siguron zbatimin e programeve të profilaksisë veterinare në lidhje me kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve epizootike.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore identifikojnë të gjithë qentë dhe macet e rrugës në territorin që ata administrojnë, në një regjistër sipas modelit të hartuar nga SPV-ja (struktura përgjegjëse për veterinarinë). Njësitë e vetëqeverisjes vendore vënë në dispozicion të AKVMB-së të dhënat e regjistrit, sa herë që i kërkohet.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë hospitalizimin e qenve dhe të maceve të rrugës nëpërmjet organizimit, grumbullimit të tyre në vende të posaçme të miratuara nga autoritetet e vetëqeverisjes vendore. Shërbimi veterinar në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë sterilizimin e tyre, me qëllim ndërprerjen e aktivitetit prodhues. Mbetjet e gjeneruara nga kryerja e sterilizimit të qenve dhe maceve të rrugës duhet të klasifikohen, etiketohen, grumbullohen, transportohen, trajtohen dhe të asgjësohen në përputhje me detyrimet e kërkesave të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, si dhe me aktet e tjera ligjore në fuqi, në fushën e mjedisit.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore në çdo rast organizojnë dhe vënë në dispozicion mjetet për transportin e qenve dhe maceve në qendrat e grumbullimit. Shërbimi veterinar i AKVMB-së siguron që mjetet e vëna në dispozicion të plotësojnë standardet e mirëqenies së kafshëve. Në çdo rast këto mjete duhet të dezinfektohen me dezinfektantë të miratuar sipas legjislacionit në fuqi.

5. Në mjediset e qendrave të hospitalizimit ose të qendrave të grumbullimit të kafshëve të miratuara nga autoritetet e vetëqeverisjes vendore kryhet eliminimi i kafshëve me metodën e eutanazisë nga shërbimi veterinar, duke përdorur një nga produktet mjekësore veterinarë të miratuara nga legjislacioni në fuqi.

6. Në të gjitha rastet kur ka braktisje të qenve dhe maceve nga pronarët përkatës, njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin masa për strehimin e tyre në ambiente të përshtatshme dhe zbatimin e të gjitha masave të nevojshme për shëndetin dhe kushtet e mirëqenies së tyre. Njësitë e vetëqeverisjes vendore informojnë brenda 10 (dhjetë) ditësh shërbimin veterinar të AKVMB-së lidhur me masat e marra.

7. ...”.

Njësia e qeverisjes vendore, referuar konstatimeve të Policisë së Shtetit⁵, mund dhe duhet të tregojë vëmendje të shtuar për kontrollin e lëvizjeve të qenve të rrugës (endacak), të cilët, po ashtu, sikurse qentë me pronar, paraqesin rrezikshmëri për cenimin e shëndetit dhe jetës së njerëzve në kushtet e moskontrollit të lëvizjes së tyre nga strukturat e ngarkuara pranë organeve të pushtetit vendor. Bashkia Tiranë, sipas legjislacionit të sipërcituar ka gjithashtu detyrimin e identifikimit të të gjithë qenëve dhe maceve të rrugës në territorin që ata administrojnë, në një regjistër sipas modelit të hartuar nga SPV-ja. Në informacionin e dhënë, nuk informohet prej Bashkisë Tiranë, për veprimtari të kryer lidhur me identifikimin dhe regjistrimin e të gjithë qenëve dhe maceve të rrugës në territorin që administrohet prej Bashkisë Tiranë. Mbajtja e këtij regjistri përveçse është detyrim ligjor, vlerësojmë se lehtëson punën e strukturave përgjegjëse në mbajtjen nën kontroll të lëvizjeve të qenëve dhe maceve të rrugës.

Jeta e personit sipas sanksionimit në nenin 21 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë mbrohet me ligj. Në funksion të parandalimit të dëmtimit dhe mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së personit, është mundësuar nxjerrja e VKB-së nr. 156/2018, sipas të cilit përcaktohet AMK si organ përgjegjës për ushtrimin e kompetencave në kontrollin e kundërvajtjeve administrative në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike. Po kështu, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë detyrimin e kontrollit të lëvizjes së qenve të rrugës (endacak) si dhe trajtimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi.

Duke e trajtuar këtë çështje në një këndvështrim më specifik, evidentojmë se Bashkia Tiranë, ushtron në përputhje me legjislacionin në fuqi, funksionet dhe kompetencat (të njohura ndryshe si “Funksione të veta”), që ajo gëzon si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, nga ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Kjo Bashki është përgjegjëse për realizimin e këtyre funksioneve (ushtrimin e kompetencave), si dhe ka lirinë dhe autoritetin të marrë vendime e të përdorë mjete për këtë qëllim, brenda hapësirës së normave, kritereve dhe standardeve të pranuar

⁵ Shkresa nr. 4431/4 prot, datë 25.05.2021, drejtuar Avokatit të Popullit.

përgjithësisht me ligj, duke zotëruar autoritet të plotë administrativ, për të kryer shërbime, investime dhe rregullime.

Një ndër funksionet e veta të Bashkisë Tiranë, në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në përputhje me përcaktimin e dhënë në nenin 23, të ligjit nr.139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, është: *“...bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: ... 9. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike. 10. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake...”*

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mbështeten në veprimtarinë e tyre të përditshme pikërisht në konceptin e autonomisë vendore, të kuptuar si, *“... e drejta dhe aftësia e njësisive të qeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë”*, siç parashikohet në nenin 2, pika 2, të ligjit nr.139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*.

Një rol të rëndësishëm në ushtrimin e kompetencave për kontrollin e lëvizjes së qenve të shoqërimin apo të rrugës (endacak) në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike ka njësia e vetëqeverisjes vendore.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit, vlerëson se Bashkia Tiranë, nëpërmjet AMK-së, është autoriteti përgjegjës për kontrollin e kundërvajtjeve administrative nga pronarët/kujdestarët e qenve të shoqërimin. Sipas VKB-së nr. 156/2018, përcaktohet qartë se AMK, pranë Bashkisë Tiranë, është e ngarkuar me kontrollin e kundërvajtjeve administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike. Njësia e vetëqeverisjes vendore është gjithashtu e ngarkuar me ligj për kontrollin e lëvizjes së qenve dhe maceve të rrugës.

Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore kërkojnë dhe kanë si kusht ushtrimin e detyrave tuaja funksionale dhe marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen e problemit të kontrollit të kundërvajtjeve administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, si dhe kontrollin e lëvizjes së qenve dhe maceve të rrugës.

Problematika që prezantohet në rrugë mediatike është tepër serioze në drejtim të shëndetit të qytetarëve. Megjithëse ekziston prej kohësh kjo problematikë⁶, ende nuk janë marrë dhe merren masat e duhura për të arritur rezultate konkrete në drejtim të garantimit të shëndetit dhe jetës së personit, si dhe sigurimit të një ambienti sa më të pastër.

⁶ Joq-albania.com Datë 09.10.2024. “Banorët e Tiranës në hall me qentë e rrugës: Kemi frikë të dalim jashtë”

Në analizë të fakteve të mësipërme, institucioni i Avokatit të Popullit synon që jo vetëm të vërë në lëvizje organet kompetente, por dhe t'i sensibilizojë ato për vetë rëndësinë që ka kjo problematikë, ndaj ne theksojmë marrjen e veprimeve konkrete për zgjidhjen përfundimtare të problemit sikundër është kontrolli i kundërvajtjeve administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, si dhe, kontrollin e lëvizjes së qenve dhe maceve të rrugës.

Në këtë kuadër, duke patur parasysh se kjo është një çështje e rëndësishme për qytetarët, të cilëve duhet t'u garantohet e drejta për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës, Avokati i Popullit dëshiron të sjellë në vëmendjen tuaj ushtrimin e detyrave funksionale dhe marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e situatës së krijuar përmes ushtrimit të kompetencave.

Për sa më sipër, për të gjitha arsyet që parashtuam, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka drejtë të bëjë rekomandimet dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga Administrata Publike...”*, si dhe në bazë të nenit 21, shkronja “b”, të ligjit nr.8454/1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*:

REKOMANDOJMË

Ushtrimin e kompetencës për kontrollin efektiv të kundërvajtjeve administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, sikurse parashikuar në nenin 16, pika 6 e VKB-së nr. 156, datë 21.12.2018, të Këshillit Bashkiak, Tiranë, “Për përcaktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Tiranë”;

Marrjen e masave për vendosjen e sinjalistikës së nevojshme që në ambientet publike, si rrugë, parqe, kënde lojrash, etj, kafshët e shoqërimit të mos paraqesin rrezik për njerëzit ose kafshët e tjera, Kreu III. “Mbikqyrja dhe mbajtja nën kontroll e qenve dhe maceve endacake pa pronarë”, pika 7;

Marrjen e masave për kontrollin dhe higjienizimin nga ndotjet e kafshëve të shoqërimit si dhe qenve e maceve të rrugës në trotuarët e rrugëve pranë vendbanimeve dhe hapësirat publike.

Mbajtjen nën kontroll të lëvizjes së qenve dhe maceve të rrugës (endacak), identifikimin e tyre në një regjistër, si dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me autoritetet mjedisore rajonale dhe shërbimin veterinar shtetëror.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, kthimi përgjigjes të kryhet brenda afatit 30 ditor lidhur me masat ligjor dhe qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi.

Duke hesuar në bashkëpunimin tuaj.